

**ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës Komora inženjera Republike Kosovo Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo			
Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit	0122	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	137/26
Nr. i faqeve Br. Stranica Nr. Pages	1	Data: Datum: Date:	11/02/2026
PRISHTINË / A			No.1

PROCESVERBAL

i Mbledhjes së Kuvendit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës

Sot, më 07.02.2026, në përputhje me thirrjen e datës 16 janar 2026 dhe në pajtim me Statutin, u hap mbledhja e Kuvendit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës.

Kryetari, me rastin e hapjes së mbledhjes, përshëndeti anëtarët e Kuvendit, Bordin Drejtues, Komisionin Disiplinor dhe të Ankesave, përfaqësuesit e Komisionit Mbikëqyrës, si dhe mysafirët e pranishëm, dhe falënderoi anëtarët për pjesëmarrjen. Kryetari uroi mirëseardhje në punimet e Kuvendit të II-të të rregullt të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, të cilat po zhvillohen sot, më 07 shkurt 2026, në Hotel Emerald.

Kryetari në hapje të mbledhjes falënderoi sponzorin kryesor logjistik për mbështetjen e këtij organizimit të Kuvendit të Rregullt Vjetor të OIRK-së, si dhe inkurajoi edhe partnerët e tjerë që të mbështesin Odën përmes sponsorizimeve në forcimin dhe zhvillimin e saj, në funksion të ngritjes së standardeve profesionale në Kosovë.

Procesmbajtëse e mbledhjes së Kuvendit u caktua znj. Leonora Muçaj, zyrtare e administratës së OIRK-së.

Para fillimit të punimeve, Kryetari kërkoi nga administrata të konstatohet kuorumi i nevojshëm për vazhdimin e mbledhjes së Kuvendit sipas statutit. Kryetari informoi anëtarët e Kuvendit se numri i anëtarëve me anëtarësi të rregulluar dhe status aktiv është 853. Gjiithashtu theksoi se, mbështetur në nenin 17 të Statutit, Kuvendi ka kuorum kur në mbledhje marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të Odës, ndërsa sipas Ligjit për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, neni 12, paragrafi 1, Kuvendi i Odës përbëhet nga anëtarët e licencuar të Odës (me përjashtim të periudhës së përkohshme të themelimit). Si rrjedhojë, për sigurimin e kuoromit të nevojshëm për zhvillimin e punimeve të Kuvendit kërkohet prania e 427 anëtarëve.

Pas evidentimit të pjesëmarrjes, u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm 348 anëtarë, çka nënkupton se nuk është arritur kuorumi i nevojshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit.

Në këto rrethana, në përputhje me Statutin, mbledhja e Kuvendit nuk mundi të vazhdojë punimet.

Për shkak të mungesës së kuoromit të nevojshëm për vendimmarrje, punimet e Kuvendit nuk mundën të vazhdojnë. Kryetari falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe shpalli ndërprerjen e seancës së mbledhjes së Kuvendit në ora 11:05, me qëllim që e njëjta të vazhdojë në një datë tjetër, për të mundësuar sigurimin e kuoromit të nevojshëm për zhvillimin e punimeve dhe vendimmarrje. Data për vazhdimin e seancës do të përcaktohet me vendim të Bordit Drejtues dhe anëtarët do të njoftohen përkatësisht.

Kryetari: Arsim Rapuca

Procesmbajtësja: Leonora Muçaj

